




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.208/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Nuhi Paqarizi– Kryetar, z.Blerim Dina–Referues dhe z. Goran Milenkovic-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE N.P“ToniImpex” – Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi i klimave për KGJK dhe Gjykata”, me nr. prokurimi: 328-19-1403-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Këshilli Gjyqësor i Kosovës-KGJK, më datën 29.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.Hedhet si e pa lejuar, ankesa e OE N.P “ToniImpex” – Gjilan, me nr. të protokollit 208/19, e datës: 10.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i klimave për KGJK dhe Gjykata”, me nr. prokurimi: 328-19-1403-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Këshilli Gjyqësor i Kosovës-KGJK, pasi që ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së në autoriteti kontraktues.

II.I LEJOHET autoritetit kontraktues–Këshilli Gjyqësor i Kosovës-KGJK që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i klimave për KGJK dhe Gjykata”, me nr. prokurimi: 328-19-1403-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Këshilli Gjyqësor i Kosovës-KGJK, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave .

IV. Me qenë se ankesa e OE N.P“Toni Impex” – Gjilan, hudhet si e pa lejuar i bëhet kthimi i tarifës së

ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V.Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 10.05.2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE “N.P“ToniImpex” – Gjilan, me nr. te protokollit 208/19 kundër njoftimit për kontrate lidhur me aktivitetin të prokurimit: “Furnizimi dhe montimi i klimave për KGJK dhe Gjykata ”, me nr. prokurimi: 328-19-1403-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Këshilli Gjyqësor i Kosovës-KGJK.

Data e njoftimit për kontratë: 21.03.2019

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52) :tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave:16.04.2019

Data e hapjes së ofertave:16.04.2019, ora 14:00

Njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe Letra standarde tenderuesin e limituar dt.19.04.2019,

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit të AK –së me dt.22.04.2019,

Vendimi i AK për kërkesën për rishqyrtim dt. 23.04.2019

Njoftimi për dhinë të kontratës dt. 07.05.2019,

Ankesa është parashtruar në OSHP 17 dite mbas afatit ligjor për ankese.

Operatori ekonomik ankues: “N.P“ToniImpex” – Gjilan si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 10.05.2019 me nr. 208/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet të transmetimit të mbledhjeve të Kuvendit Komunal, takimeve të bordit të Drejtoreve, konferencave për media, të gjitha aktiviteteve në terren, shpallje të ndryshme të realizimit të promote”, me nr. prokurimi: GL651-19-010-136, përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 28,59,60,61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.05.2019, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-se me datën: 22.04.2019. Me datën 23.04.2019, AK merr vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues. Me datën 10.05.2019, OE kundër vendimit të lartcekur parashtron ankesë në OSHP. Mirëpo në baze të dëshmive të analizuar konstatohet se ankesa e dorëzuar në OSHP është jashtë afatit përdorëzimit të ankesave në Organin Shqyrtues të Prokurimit për faktin se nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave thotë: Periudha kohore për dorëzimin e një ankesë në OSHP. 9.1 Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues ka dorëzuar ankesë në OSHP 17 dite nga dita e pranimi të vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, andaj ankesa si e tillë nuk mund të shqyrtueset në OSHP sepse e njëjta është parashtruar në OSHP pas afatit ligjor për parashtrim të ankesës. Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar me datën: 10.05.2019, nga ana e OE N.P. "ToniImpex" – Gjilan është e pa lejuar dhe se e njëjta nuk mund të hyn në shqyrtim nga ana e OSHP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se ankesa e parashtruar me datë: 10.05.2019 nga OE "N.P. "ToniImpex" – Gjilan në Organin Shqyrtues të Prokurimit është dorëzuar në OSHP në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave sepse neni i lartcekur specifikon se: Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE N.P “ToniImpex” – Gjilan me nr. te protokollit 208/19 dhe ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga operatori ekonomik i cekur si me lart është e pa lejuar për arsyet e dhëna si më lart.

Kryetari i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi



Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës
2. 1x1 OE “N.P”“ToniImpex” – Gjilan
3. Arkivës së OSHP-së